



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr.199, datë 12.05.2021**

**PËR**  
**MBYLLJEN E PROCEDIMIT PA ZHVILLUAR SEANCË DËGJIMORE PËR ISH**  
**MAGJISTRATËT {...} DHE {...}**  
**DHE CAKTIMIN E SEANCËS DËGJIMORE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË**  
**INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR FILLIMIN E PROCEDIMIT**  
**DISIPLINOR NË NGARKIM TË MAGJISTRATIT {...}, ME DETYRË GJYQATAR NË**  
**GJYKATËN E APELIT DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 138, pika 2 dhe nenin 139 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 31, pika 1 dhe 2 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj;

**V E N D O S I:**

1. Mbylljen e procedimit disiplinor të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj ish magjistratit {...}, pa zhvilluar seancë dëgjimore.
2. Mbylljen e procedimit disiplinor të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj ish magjistratit {...}, pa zhvilluar seancë dëgjimore.
3. Kundër pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve, afat i të cilit fillon nga e dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Caktimin e datës 26.05.2021, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
5. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ish magjistratëve {...}, {...} dhe magjistratit {...}, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**